

PRIZRINI NË RETROVIZORE
PRIZREN THROUGH THE RETRO-VISOR



Publikues

Organizata jo-qeveritare
Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC Ma Ndryshe

Financuar nga

CHwB - Trashëgimia Kulturore
pa Kufij, Kosovë

Përshkrimet e fotografive

Sokol Cena dhe
EC Ma Ndryshe

Fotografitë (2009)

Samir Karahoda

Editimi dhe Dizajni

Edon Mullafetahu

Shtypi

xxxxxxx

Tirazhi

100

© Të gjitha të drejtat e rezervuara

Publisher

Non-governmental organization
Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC Ma Ndryshe

Financed by

CHwB - Cultural Heritage without
Borders, Kosovo

Description of photos

Sokol Cena and
EC Ma Ndryshe

Photos (2009)

Samir Karahoda

Edited and Designed by

Edon Mullafetahu

Printing


xxxxxxx

Circulation

100

© All rights reserved

Pozitat e fotografimit / Picture viewpoint positions



Objektet Monumentale
 Monumental Buildings

Objektet e Listuara
 Listed Buildings

Pozitat e fotografimit
 Picture viewpoint positions

Përmbajtja

2	Dy Fjalë për katalogun
5	Krahasimi i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit
6	Lagjia e Arastës
8	Peisazh qyteti
10	Kalaja dhe Nënkalaja
12	Nënkalaja
14	Kafe-Çajtorja
16	Lidhja Shqiptare e Prizrenit
18	Lagjia e Marashit
20	Peisazh qyteti
22	Kompleksi Arasta
24	Rruga e Kazanxhivë
26	Ura e Gurit
28	Motiv nga Shadërvani
30	Kujumxhillëku
32	Rrugicë e Nënkalasë
34	Rruga e Nallbanëve
36	Rruga e Pushkatarëve

Contents

2	A few words about the Catalogue	2
5	Comparison of old / new images of Prizren	5
6	Neighborhood of Arasta	7
8	City landscape	9
10	Castle and Nënkalaja	11
12	Nënkalaja (below - Castle)	13
14	Café and Tea Shop	15
16	Albanian League of Prizren	17
18	Marash Quarter	19
20	City Landscape	21
22	Arasta Complex	23
24	Street of Kazanxhis	25
26	Stone Bridge	27
28	Motif from Shadërvan	29
30	Kujumxhillëk	31
32	A Nënkalaja back-street	33
34	Street of Nalbans	35
36	Street of Gunsmiths	37

Dy fjalë për katalogun

Prizreni, ç'ishte, ç'është dhe ç'do të jetë? Pyetjen e Sami Frashërit për Shqipërinë, të transformuar, po e parashtrijmë për Prizrenin. Se ç'ishte dhe ç'është, një përgjigje sado të kufizuar na ofron ky katalog karahasues. Ndërsa na mbetet të shohim se çfarë e ardhme e pret qytetin. Në fakt, pasi që të ecni nëpër histori përmes fotografive në faqet e këtij katalogu, në fund, fare lehtë mund ta parashikoni të ardhmen e këtij qyteti. Do të vëreni se për një kohë shumë të shkurtër, madje vetëm për disa dekada, Prizreni është transformuar totalisht. Madje në disa raste (fotografi) as që dallohet se fjala është për Prizrenin. Prandaj, nuk keni nevojë për aftësi të mëdha profetike për të ditur se ç'po e pret Prizrenin. Nëse vazhdohet me qasje të njëjtë, me neglizhencë totale ndaj vlerave të qytetit, atëherë e ardhmja e tij do të jetë edhe më e degraduar. Identiteti i qytetit do të transformohet në një masë të atillë, që edhe fotografitë e vitit 2009 të cilat janë pjesë e këtij katalogu, do të jenë një realitet i dëshirueshëm për të gjithë ne.

Prizreni, ç'ishte, ç'është dhe ç'do të jetë? Ky qytet, i cili ka arritur që të mirëmbajë vlera të mëdha të trashëgimisë kulturore me shekuj, po vazhdon të shkatërrohet me një shpejtësi marramendëse. Ato vlera që popuj të ndryshëm i krijuan, ndërtauan dhe i ruajtën me devotshmëri, përgjatë tërë historisë së ekzistencës së qytetit, ne sot, po i trajtojmë sikur të ishin vepra të parëndësishme dhe gjithë këtë mund shumë shëkullor po e shpërblejmë me subordinim të këtyre vlerave

A few words about the Catalogue

What was Prizren, what is it and what is going to be? The question of Sami Frashëri for Albania, transformed, is being posed for Prizren. About what it was and what it is, to a certain extent we can learn from this comparative catalogue. While there is still to be seen what will be its future. In fact, during your historic walk through the photos of the catalogue, in the end, slightly you would predict the future of this city. You will notice that for a very short period of time, even within few decades, Prizren has been transformed totally. Moreover, in certain cases (photos) you will barely recognize that it is Prizren. Therefore, you don't need great prophetic skills to anticipate the next to come. If we continue to have the same approach, neglecting the values of the city, than its future will be further degraded. The identity of the city will get transformed to a such degree, that even the photos of 2009, which are part of this catalogue, will become a desired reality for all of us.

What was Prizren, what is it and what is going to be? This city, which has managed to maintain great values of cultural heritage with ages, is being destroyed with a tremendous speed. Those values that have been created, built and preserved with dedication by different nations, during the whole history of the existence of the city, are nowadays being treated by us, as they were irrelevant works, and we are disbursing all this ages-long effort by subordinating these

ndaj nevojave tona të përditshme, nga më bizaret. Dhe më e keqja, po dëshmohe mi se jemi larg vetëdijes së qytetarit të djeshëm dhe të pardjeshëm të Prizrenit, i cili ka menduar për ne dhe i ka ruajtur këto vlera për ne. Ndërsa ne, thjesht po ia vjedhim këtë pasuri qytetarit të nesërm të Prizrenit. Ne po dëshmohe mi gjenerata më e papjekur dhe e pacivilizuar që ka jetuar ndonjëherë në këtë qytet. Ky turp dhe kjo përgjegjësi i takon gjithë atyre që pretendojnë se janë pjesë e këtij qytetit, apo identifikohen me vlerat dhe civilizimin e Prizrenit. Të gjithë ne, deri tani, kemi dështuar në provimin tonë të pjekurisë qytetare. E ardhmja e këtij qyteti do të jetë matësi kryesor i fajësisë sonë. Prizrenasi i së ardhmes do të na gjykojë për të gjitha veprat dhe mosveprimet e sotme. Se ç'do të jetë Prizreni, le të gjykojë secili për vete dhe brenda gjykimit të tij të merr pjesën e vet të përgjegjësisë.

Katalogu krahasues ofron një pasqyrë krahasimi mes dy Prizrenëve, atij të vjetër, i cili ilustron me fotografi të vjetra të vendosur në anën e majtë, dhe pamjes së sotme të qytetit, të pasqyruar me fotografime nga e njëjta perspektivë sikur fotografia korresponduese në anën e djathtë. Të gjitha fotografitë përmbajnë nga një përshkrim të shkurtër mbi lokacionin, objektet që shihen dhe vlerat që pasqyrohen. Përshkrimet janë të shkurtra ngase krahasimi i fotografive flet vetë. Shumë bile, më shumë se çdo fjalë e frazë.

values to our daily needs, to most bizarre ones. The worst, we are proving to be far from the consciousness of the yesterday's and the day before yesterday's citizen of Prizren, which have thought and preserved these values for us. But, we are simply stealing this wealth from the tomorrow's citizen of Prizren. We are proving to be the most immature and uncivilized generation that has ever lived in this city. This shame and this responsibility belong to all those that pretend being part of this city, or identify themselves with the values and civilization of Prizren. All of us, to date, have failed in our citizen maturity exam. The future of this city will be the main measurement of our guiltiness. The future Prizren citizen will judge us for all of our actions and inactions of today. For the Prizren of future, let everyone judge for himself/herself and inside its judgment take his/her part of responsibility.

The comparative catalogue offers a comparative picture among two Prizrens, the old one, which is illustrated by the old photos placed left side, and the current view of the city, reflected by the photos from the same perspective of the corresponding photo in the left. All photos have short descriptions about the location, objects that are seen and values that are reflected. Descriptions are short because the photo comparison speaks itself. It speaks a lot, more than any word or phrase.

Krahasimi i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit
Comparison of old/new images of Prizren



①

Lagjia e Arastës

Në vend të ndërtesës ku gjendej barnatorja, në lagjen e Arastës në mes të viteve 1960 – 1962 u ndërtuan katër ndërtesa shumë-katëshe, në mesin e tyre, edhe kjo ndërtesë e lartë, me karakter shëmtues për qendrën e qytetit, e cila gjendet pranë Hotel Therandës.

1955- '60



①

Neighborhood of Arasta

To replace the building where the drugstore was located, in the neighborhood of Arasta during the years 1960 – 1962, four multistory buildings were constructed, one of them being the respective high building, with an uglifying purpose for the city center, which is right in front of Hotel Theranda.

2009



2

Peisazh qyteti

Një motiv i zhdukur nga Ura e Re (e Therandës), shtëpitë pranë Lumbardhit dhe Ura e Gurit, fotografuar gjatë viteve 1937 – 1938. Në bregun e djathtë të Lumbardhit në vitin 1938 ndërtohet muri i ultë prej gurëve të thyer, me ç'rast rrënohen edhe shtëpitë në lum dhe pranë tij. Rindërtimi i tyre, në të njëjtin vend, fillon më 1948.

1937- '38



2

City landscape

An evaporated motif from the New Bridge (of Theranda), houses near Lumbardhi and Stone Bridge, pictured around 1937 – 1938. On the right riverside of Lumbardhi in 1938, a low-down wall from broken stone was built, destroying the houses on and beside the river. Their reconstruction, in the same location, starts in 1948.

2009



3

1941- '43

Kalaja dhe Nënkalaja - Në fotografiminë e vjetër, të realizuar rreth viteve 1941 – 1943, shihet një peisazh karakteristik i Prizrenit (Ura e re, Nënkalaja dhe Kalaja). Ura e re, e ndërtuar në vitin 1936 në vend të Urës së Arastës, më 1964 me ndërtimin e hotelit më të madh të Prizrenit, mori edhe emrin Ura e Therandës. Sot kjo urë qëndron e zbehtë, poshtë kalasë së mbuluar dhe të degraduar dhe Nënkalasë së shkatërruar.



3

2009

Castle and Nënkalaja - The old photo, pictured around the years 1941 – 1943, shows a peculiar landscape of Prizren (New Bridge, Nënkalaja and Castle). The New Bridge, built in 1936 to replace the Bridge of Arasta, in 1964 after the biggest hotel of Prizren was constructed, got renamed as the Bridge of Theranda. Nowadays, this bridge looks palish, standing below the covered and degraded Castle and the destroyed Nënkalaja.



4

1960- '65

Nënkalaja - Lagjia e Nënkalasë, pranë shkollës së muzikës "Lorenc Antoni", i takon Komplexit përmendorak të Nënkalasë. Ndërtohet në shpatet e kalasë si paralagje në formë të amfiteatrit. Karakteristikë e lagjes janë shtëpitë e dendura me oborre të vogla, ndërsa shkatërrimi i pësuar viteve të fundit ka shëmtuar dhe degraduar, pjesën, sipas disa vlerësimeve, më të bukur të qytetit të Prizrenit.



4

2009

Nënkalaja (below-Castle) - The Nënkalaja neighborhood, near the music school "Lorenc Antoni", belongs to the monumental Complex of Nënkalaja. It was built in the hillside of the castle as an amphitheatre-shape neighborhood. Its characteristics are dense houses with small yards, while the recent destructions have uglified and degraded, according to some assessments, the most beautiful part of Prizren.



Kafe-Çajtorja

Kafe-Çajtorja gjendej në anën e majtë të Lumbardhit, pranë Urës së Therandës dhe Shkollës Ortodokse Serbe Bogoslovija. Kjo kafe-çajtore në përdhësën e saj kishte një kthinë të vogël, që herë shërbente si qebaptore e herë si këpucëtari ose dyqan bojash (ngjyrash). Deri në vitin 1908 ka ekzistuar edhe kati i dytë, ndërsa në këtë vit ai digjet bashkë me kulmin dhe kjo pjesë nuk riparohet më kurrë.

5

-1950



Cafe and Tea Shop

Cafe and Tea Shop was located on the left side of Lumbardhi, near the Bridge of Theranda and the Serbian Orthodox School Bogoslovija. The Cafe and Tea Shop had a small carrel in the ground floor, which served as either a shoemaker or a shop of colors. Until 1908 it preserved its first floor as well, while in that year it gets burned together with the roof and this part was never repaired again.

5

2009



6

Lidhja Shqiptare e Prizrenit

Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit shtrihet në pikën më delikate të hapësirës urbane të qytetit, i rrethuar nga Lumbardhi, Kompleksi i Marashit dhe shtëpitë e Kalasë së Prizrenit. Përveç vlerave të kulturës materiale, Kompleksi ka një rëndësi të madhe historike, pasi që në Medresenë dhe Xhaminë e Mehmed Pashës u mbajt Kuvendi Themelues i LSHP. Në vitin 1968 ky Kompleks është riemëruar Sheshi Lidhja e Prizrenit.

1942



6

Albanian League of Prizren

The Complex of Albanian League of Prizren lies on the most delicate point of the urban area of the city, surrounded by Lumbardhi, Marash Complex and houses of Prizren Castle. Besides the values of material culture, this Complex has a great historical importance, as in the Madrasah and Mosque of Mehmed Pasha the Founding Assembly of the ALP was held. In 1968 this Complex was renamed as Prizren League Square.

2009



7

Lagjia e Marashit

Lagjia e Marashit bën pjesë në Kompleksin e Marashit dhe gjendet në mes të urave të Lidhjes dhe të Marashit. Për shkak të konfiguracionit të terrenit, mbetet njëra ndër lagjet më të vogla të qytetit. Karakteristikat e lagjes së Marashit janë krojet “Topokli”, shëtitorja e ndërtuar rishtazi dhe natyrisht Xhamia e Maksut Pashës. Ndërtimet e pakontrolluara dhe rrënimet e shumta e rrezikojnë edhe këtë lagje karakteristike të qytetit, e cila sot i kanoset rrezikut të zhdukjes totale si pasojë e intervenimit të egër urbanistik.

1954



7

Marash Quarter

The Marash Quarter belongs to the Complex of Marash and it is located between the bridges of League and Marash. The characteristics of Marash Quarter include “Topokli” fountains, recently built promenade and surely the Mosque of Maksut Pasha. Uncontrolled buildings and frequent devastations are seriously endangering this peculiar neighborhood of the city, which nowadays faces the risk of total disappearance as a result of wild urban intervention.

2009



8

Peisazh qyteti

Një pjesë e Kompleksit të Arastës rreth viteve 1955 – 1958, në vendin ku u ndërtua Hotel Theranda. Në këtë perspektivë të gjerë të Prizrenit, syri lehtësisht mund ta identifikojë degradimin dhe ndryshimin e identitetit që ka pësuar qyteti.

1955- '58



8

City landscape

One part of Arasta Complex around the years 1955 – 1958, in the place where Hotel Theranda was built. In this wide perspective of Prizren, the eye easily identifies the degradation and the change of identity that the city experienced.

2009



9

Kompleksi Arasta

Në fotografinë e vjetër shihet një pjesë e dyqaneve të Kompleksit Arasta, ku sot gjenden Hotel Theranda dhe Posta e Kosovës. Fotografia është realizuar në ditët e fundit të këtij Kompleksi, pra në kohën kur pritej rrënimi i dyqaneve për ndërtimin e objekteve të hotelit dhe postës, diku rreth pjesës së dytë të viteve të 50-ta.

1956- '58



9

Arasta Complex

The old photo captures one part of shops in the Arasta Complex, where currently Hotel Theranda and Kosova Post Office are situated. The photo was taken in the last days of this Complex, when its shops were waiting to be pulled down and replaced by the buildings of hotel and post office, sometimes around the late 50s.

2009



Rruga e Kazanxhive

Rruga e Kazanxhive gjendet në anën e djathtë të Lumbardhit, përballë Urës së Gurit, e cila e lidh atë me Shadërvanin. Ndryshe njihet edhe si Rruga e Haxhi Farisë dhe si Rruga e Teqesë. Kjo rrugë i ka shpëtuar rrënimëve dhe shkatërrimeve të kohërave dhe regjimeve të ndryshme, por jo edhe veprimeve degraduese të kohëve të fundit.

10
1965- '70



Street of Kazanxhis

The Street of Kazanxhis (coppersmith) is on the right side of Lumbardhi, in front of Stone Bridge, which connects it with Shadërvan. It is also known as the Street of Haxhi Fari and the Street of Tekke. This street has managed to survive from the destruction and devastation of different times and regimes, but not from those of recent times.

10
2009



11

Ura e Gurit

Ura e vjetër e Gurit u ndërtua nga Ali Beu në shekullin 16. Ura kishte trajtë harku, e ndërtuar prej kuadrash guri të lidhura me suvë gëlqerore. Ura i bëri ballë shumë ujërave dhe sfidave të kohës, por jo edhe vërshimit të vitit 1979. Më 1982 rikonstruohet në tërësi dhe i kthehet pamja atraktive, ndonëse me një ndryshim përmbajtësor.

1954



11

Stone Bridge

The old Stone Bridge was built by Ali Bey in the 16th century. The bridge had archwise shape, constructed with stone frames linked with lime plaster. The bridge resisted many challenges of time, but not the flood of 1979. In 1982 it was reconstructed totally and its previous view was preserved, though with a relevant difference.

2009



Motiv nga Shadërvani

Një nga pjesët e brendshme dhe hyrja e Kujumxhillëkut nga Shadërvani, një pjesë e Shadërvanit dhe Xhamia e Sinan Pashës, diku rreth viteve 1960 – 1965. Zejtaria e Prizrenit është shkatërruar pikërisht në pikën më neuralgjike të saj, me shkatërrimin e dyqaneve të vogla dhe ndërtimet e mëdha dhe të pakuptimta.

12

1960-1965




Motif from Shadërvan

One of the inner parts and the entrance of Kujumxhillëk from Shadërvan, one part of Shadërvan and the Sinan Pasha Mosque, sometime around the years 1960 – 1965. The craftsmanship of Prizren was destroyed exactly in its most neuralgic point, with the destruction of its small stores that were replaced by huge and absurd buildings.

12

2009



13

Kujumxhillëku - (Argjendaria) gjendej në pjesën perëndimore të Shadërvanit, aty ku gjendeshin dyqanet hyrëse të saj për të vazhduar në brendi, ku ishin të vendosur edhe briskaxhinjtë, tyfekxhinjtë (armëpunuesit), etj. Në vitin 1967 fillon rrënimi i një pjese të saj, përfshi edhe dyqanet e makaxhinjve, briskaxhinjve, tyfekxhinjve, për të ndërtuar shtëpinë e mallrave "Liria", e cila hyri në funksion më 1970. Dyqanet e mbetura të zejeve tradicionale në kuadër të Kujumxhillëkut, si pasojë e rrethanave rënduese dhe moskujdesit u detyruan të ndërrojnë destinacion, ndërsa sot pjesa më e madhe e tyre funksionojnë si kafeteri dhe shërbime tjera afariste.

1921



13

Kujumxhillëk - Kujumxhillëk (Goldsmiths) was located in the western part of Shadërvan, close to its entrance stores that led to the inner parts, and where the cutlers, gunsmiths and others were located. One part of it was destroyed in 1967, including stores of scissor-makers, cutlers, gunsmiths, to build the shopping mall "Liria", which was operational in 1970. The remaining stores of traditional handicrafts in Kujumxhillëk changed their destination due to the hard conditions and lack of care, while nowadays most of them operate as cafe shops and other businesses.

2009



Rrugicë e Nënkalasë

Njëra ndër rrugicat me arkitekturë folklori në Kompleksin e Nënkalasë, fotografuar rreth viteve 1960 – 1965. Rrugica në Kompleksin e Nënkalasë që fillonte me një bankë private në të djathtë dhe me një hotel në të majtë të rrugës. Gjendet në anën e majtë të rrugës së Gjimnazit të vjetër.

14

1960-1965



A Nënkalaja back-street

One of the back-streets with folklore architecture in the Nënkalaja Complex pictured around years 1960 – 1965. This back-street in Nënkalaja Complex, which used to have a private bank on its right side and a hotel in the left, is located in the left side of the street of former Gymnasium (college).

14

2009



Rruga e Nallbanëve

Rruga e Nallbanëve gjendet në pjesën jug-perëndimore të Shadërvanit, në drejtim të Qafëpazarit, konkretisht në kthesën e tretë të Shadërvanit në të djathtë, përballë Kishës Ortodokse "Shën Gjergji". Kjo rrugë njihej për dy punëtoritë e nallbanëve, të vendosura përballë njëra tjetrës.

15

1965- '70



Street of Nallbans

The Street of Nallbans (farrier) lies on the south-western part of Shadërvan, in the direction of Qafëpazari, precisely in the third turn-round of Shadërvan by the right side, in front of Orthodox Church "Saint George". This street was renowned for its two farrier manufactories, placed in front of each other.

15

2009



16

Rruga e Pushkatarëve

Rruga e Shuaip Pashës (Spahiut), e riemëruar Rruga e Pushkatarëve gjendet përballë Urës së Lanetit dhe vazhdon deri përballë Kishës Katolike dhe del në Sheshin Shadërvan. Krahas ndryshimeve të mëdha, rruga ka ndryshuar edhe emrin, duke u emëruar me një profesion që nuk lidhet aspak me këtë rrugë.

1964- '68



16

Street of Gunsmiths

The Street of Shuaip Pasha (Spahi), renamed as the Street of Gunsmiths is located in front of the Lanet Bridge and continues until the Catholic Cathedral and reaches Shadërvan Square. Except many big changes, the street has changed its name too, being called with a profession which has nothing to do with this street.

2009



17

-1990

Shtëpia e Shuaip Pashës - Shtëpia e Shuaip Spahiut (Pashës) gjendet në udhëkryqin e rrugës Rrasat e Kosharës dhe asaj të Pushkatarëve dhe pranë Urës së Lanetit (e quajtur e lanetit ngase rrënohej sa herë që vërshonte Lumbardhi). Shtëpia u ndërtua në fillim të shekullit XIX nga Shuaip aga, udhëheqës i shquar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kjo shtëpi u shkatërrua deri në themel në vitin 1999 dhe është në pritje të rindërtimit.



17

2009

House of Shuaip Pasha - The house of Shuaip Spahiut (Pasha) is located in the crossroads of Rrasat e Kosharës and Gunsmiths street, near the Lanet (devil) Bridge (named devil's as it got destroyed each time Lumbardhi flooded). The house was built in the 19th century by Shuaip aga, a distinctive leader of Albanian League of Prizren. It was destroyed totally in 1999 and it is expecting to be reconstructed.



Shtëpitë e vjetra

Shtëpia e vjetër në fotografiminë e vjetër, gjendej pranë shtëpisë së Shuaip Spahiut (Pashës) dhe Urës së Lanetit. Sot, në rrugën Rrasat e Kosharës dominon “modernja”, urbanizmi i egër dhe kapitalizmi. Në zonën historike të Prizrenit kanë humbur mbi 60% të shtëpive të ndërtuara para Luftës së Dytë Botërore.

18

1965- '70



Old houses

The old house in the old photo was located near the house of Shuaip Spahi (Pasha) and the Lanet Bridge. Today, in the street of Rrasat e Kosharës, the “modern”, wild urbanism and capitalism are dominant. Within the historic area of Prizren, more than 60% of houses built before the World War II are lost.

18

2009



Kroi i Bimbashit

Në fotografinë e vitit 1964 shihet Kroi i Bimbashit, i cili u vlerësua si përmendore kulturore më 1977. Kroi gjendet në udhëkryqin afër Xhamisë së Ilaz Kukës, ndërsa koha e saktë e ndërtimit të tij nuk dihet. Kroi i Bimbashit është ndër të fundit që kanë mbijetuar në mesin e 150 krojeve që i kishte Prizreni.

19
1964



Fountain of Bimbashi

The Fountain of Bimbashi pictured in 1964, was classified as a cultural monument in 1977. The fountain is located in the cross-road near the Mosque of Ilaz Kuka, while there are no exact evidences of its date of construction. The Fountain of Bimbashi is among the last ones that survived, of the 150 fountains that Prizren had previously.

19
2009



20

Peisazh qyteti

Pamja e bregut të majtë pranë Urës së Rinisë dhe Kroit të Bimbashit. Me urbanizim të egër dhe larg shijeve estetike, qyteti ka humbur një prej detajeve më të bukura të tij, hapësirën mes Urës së Rinisë dhe asaj të Lanetit (djallit). Kjo perspektivë ofron një pamje mahnitëse të Kalasë së Prizrenit dhe Kompleksit të Nënkalasë.

1967- '70



20

City landscape

The left riverside near the Youth Bridge and Mimbashi Fountain. Thanks to the wild urbanization and disrespect to esthetic aspects, the city has lost one of its most beautiful details, the area between the Youth Bridge and the Lanet (devil) Bridge. This perspective offers a magnificent view of Prizren Castle and Nënkalaja Complex.

2009



21

Bregu i djathtë i Lumbardhit

Në fotografiminë e vjetër, në pamjen nga shtëpia e Destan Kabashit, pranë Urës së Rinisë shihet një pjesë e Shadërvanit, Xhamia e Sinan Pashës dhe Kompleksi i Nënkalasë. Pamja aktuale dëshmon për intervenime të egra dhe degradim të pamjes dhe peisazhit karakteristik të kësaj pjese të qytetit.

1967-70



21

Right riverside of Lumbardhi

In the old photo, which looks from the house of Destan Kabashi, in the area near the Youth Bridge, one part of Shadërvan, Sinan Pasha Mosque and Nënkalaja Complex are captured. The current view proves the wild interventions and degradation of the distinct landscape of this part of the city.

2009



Kisha e Shën Premtës

Kisha e Shën Premtës gjendet në skajin perëndimor të qendrës urbane të Prizrenit. Më 1306 – 1307 rindërtohet mbi themelet e një tempulli pagan kushtuar hyjneshës ilire të plleshmërisë. Nga mbreti serb Millutin shndërrohet në kishë ortodokse, ndërsa me ardhjen e osmanëve në xhami. Më 1923 minarja rrënohet, për t'u zëvendësuar me këmbanën aktuale.

22
1960-1965



Saint Friday's Church

The Saint Friday's Church is located in the western end of the urban center of Prizren. During 1306 – 1307 it was rebuilt on the foundations of a pagan temple devoted to Illyrian goddess of fertility. The Serbian king Milutin transformed it into an orthodox church, while the ottomans into a mosque. In 1923 the minaret was destroyed and replaced by the current bell.

22
2009



23

1930

Beledija - Ndërtesa e Beledijes (Bashkisë) gjendet në Kompleksin e Tabakhanes, në mes të shkollës fillore Emin Duraku dhe Kuvendit Komunal të Prizrenit. Në prapavijë të fotografisë së vjetër shihet Xhamia e Mustafë Pashës, e rrrënuar më 1961. Objekti i Beledijes është përdorur për destinime të ndryshme (bashki, arkiv, ent statistikor) dhe paraqet dëshmi të jetës së organizuar institucionale të Prizrenit.



23

2009


Beledije - The Beledije (Municipality) building is situated in Tabakhane Complex, in between of Emin Duraku primary school and Prizren Municipality. In the background of the old photo there is the Mosque of Mustafa Pasha, pulled down in 1961. The Beledije building was used for different purposes (municipality, archive, statistics institute) and is a clear proof of Prizren's organized institutional life.



24

Lagjia e Suzi Çelebisë dhe Tabakhanes - Në të djathtë të brigjeve të Lumbardhit gjendet shëtitorja që fillon nga ndërtesa e Beledijes (Bashkisë) deri tek Ura e Tabakhanes, të ndërtuar nga Suzi Çelebi në vitin 1513. Ura ishte ndërtuar me gurë dhe kishte tre harqe (harku i fundit i mbetur u rrënuar kohëve të fundit). Përballë Urës gjendet Xhamia e Suzi Çelebisë dhe tyrbeja e saj ku është varrosur ndërtuesi Çelebi.

1963



24

Suzi Çelebi and Tabakhane neighborhood - In the right hand of Lumbardhi riverside there is a promenade that begins from the Beledije (municipality) building up to the Bridge of Tabakhane, built by Suzi Çelebi in 1513. The bridge was built by stone and had three arches (the last remaining arch was destroyed recently). In front of the bridge there is the Mosque of Suzi Çelebi and its tyrbe, where the constructor Çelebi is buried.

2009



25

Terzi Mëhalla

Terzi Mëhalla (Lagjia e Terzive) i takon lagjeve të anës së majtë të Lumbardhit. Gjetet në pjesën jug-perëndimore të qytetit dhe përmendet që nga viti 1592 si Mamzi Mëhallë. Por, pas ndërtimit të Xhamisë së Mehmet Lezi Beut më 1721 nga ana e Memish rrobaqepësit (terziut), fillon të njihet në bazë të emrit të xhamisë, respektivisht në bazë të ndërtuesit të saj. Terzi Mëhalla është lagjia (mëhalla) më e madhe e Prizrenit, ndërsa viteve të fundit gradualisht po e humb bukurinë e saj karakteristike.

1955- '60

**Street of Terzis**

25

The Street of Terzis (tailors) belongs to the streets of the left hand side of Lumbardhi. It lies on the south-western part of the city and it is mentioned since 1592 as Mamzi Neighborhood. But, after building the Mosque of Mehmet Lezi Bey in 1721 from Memish the Tailor, it starts being called according to the mosque's name, respectively according to its builder. The Street of Terzis is the biggest one in Prizren, while it is gradually losing its characteristic beauty.

2009



26

1954

Kroi afër shtëpisë së Shuaip Pashës

Kroi afër shtëpisë së Shuaip Spahiut (Pashës), i rrënuar tërësisht. Sot në këtë hapësirë (rruga Rrasat e Kosharës) gjendet një parking automjesh dhe rrënojat e shtëpisë së Shuaip Spahiut (Pashës) pranë Urës së Lanetit (djallit).



26

2009

Fountain near the house of Shuaip Pasha

The Fountain near the house of Shuaip Spahiut (Pasha) is destroyed totally. Today, in this space (Str. Rrasat e Kosharës) there is a car parking and the ruins of the house of Shuaip Spahiut (Pasha) near the Lanet (devil) Bridge.



Rruga e Saraçëve

Rruga e Saraçëve njihet me këtë emër shkaku i Saraçhanes. Kjo rrugë ishte në mesin e shumë rrugëve të qytetit nëpër të cilën kalonin kanalet e ujit dhe përroskat që përshkonin shtëpitë e lagjes dhe përbënin një karakteristikë dalluese të Prizrenit në krahasim me qytetet tjera të Kosovës.

27

1960



Street of Saraçs

The Street of Saraçs (saddlers) is known by this name because of Saraçhane (Saddlery). This street was among many streets of the city, through which the water channels and ravines passed and touched upon the houses, a distinct characteristic of Prizren in comparison to other cities of Kosova.

27

2009



28

1930

Kompleksi i Marashit - Kompleksi i Marashit shtrihet në pjesën lindore të qytetit. Shkatërrimi i këtij Kompleksi filloi në vitin 1946 me rrënimin e Kafe-çajtores së Marashit dhe Teqesë së tarikatis Saad. Gjatë viteve të 90-ta, por edhe gjatë dekadës së fundit Marashi ka humbur pjesën më të madhe të objekteve dhe vlerave të tij karakteristike (burimi i ujit në rrap, mulliri Shotman).



28

2009

Marash Complex - The Marash Complex is situated in the eastern part of the city. The destruction of this Complex has begun in 1946 with the pulling down of the Cafe and Tea Shop of Marash and the Tekke belonging to Saad sect. During the 90s, but also in more recent years, Marash has lost the most of its peculiar sites and values (the spring under plane tree, Shotman mill).



29

Mulliri Shotman

Mulliri Shotman u ndërtua në vitin 1641 dhe i takon Kompleksit të Marashit. Gjetet pranë Urës së Marashit dhe Xhamisë së Maksut Pashës. Deri në vitin 1994 ishte i vetmi mulli i mbetur nga 125 sosh që kishte Prizreni në shekullin 18. Sot, në vend të tij është ndërtuar mullini i ri, i cili shërben si kafe-çajtoare.

1953- '60



29

Shotman Mill

The "Shotman" Mill was built in 1641 and belongs to the Complex of Marash. It is located near the Marash Bridge and the Mosque of Maksut Pasha. Until 1994 it was the only remaining mill from 125 in total that were in Prizren during the 18th century. Today, it is replaced with a new mill, which functions as a cafe and tea shop.

2009



Banka private

Banka private "Banka e Prizrenit" e Haxhi Luba Patërnagiqit, në fotografinë e vjetër, në pamjen e vitit 1931, i takon Kompleksit të Nënkalasë, përballë Kishës Ortodokse Shën Gjergji, në rrugën e Gjmnazit të Vjetër.

Private bank

The private bank "Bank of Prizren" of Haxhi Luba Patërnagiq, in the old photo pictured in 1931, belongs to the Nënkalaja Complex, in front of the Saint George Orthodox Church, in the street of Old Gymnasium.



30

1931
/2009

Motiv nga Nënkalaja

Në fotografinë e vjetër shihen gratë nga Gjakova, Rahoveci e Peja duke pushuar para rrugëtimit të metejshëm drejt vendit të shenjtë në Lez. Në këtë pjesë të Nënkalasë, sot gjendet shkolla e mesme e muzikës "Lorenc Antoni", ndërsa urbanizimi i egër ka mbuluar bukurinë e peisazhit të kësaj ane.

Motif from Nënkalaja

The old photo shows women from Gjakova, Rahovec and Peja taking a brake before the rest of their journey towards the sacral place in Lez. In this part of Nënkalaja, today, the music school "Lorenc Antoni" is located, while the wild urbanism has covered the beauty of the landscape of this area.



31

1925
/2009

Shadërvani

Shadërvani është bërthama dhe simboli i qytetit të Prizrenit. Gjendet në anën e majtë të Lumbarðhit, ndërsa në të kaluarën është quajtur edhe “Merxhan Çarshi”. Në qendër të Shadërvanit gjendet kroi, ndërsa pikat që e kufizojnë lagjen janë: Ura e Gurit në veri, Xhamia e Sinan Pashës në lindje, Kompleksi Panteli në jug, Qafëpazari në jugperëndim dhe Kujumxhillëku në perëndim.

**Shadërvan**

Shadërvan is the nucleus and the symbol of Prizren. It is situated in the left side of Lumbarðhi, and previously it was known as “Merxhan Çarshi” as well. In the middle of Shadërvan there is the fountain, while the boundary points of the square include: Stone Bridge in north, Sinan Pasha Mosque in east, Panteli Complex in south, Qafëpazari in south-west and Kujumxhillëk in west.



32

1950
/2009**Ura e Therandës (Arastës)**

Ura e Re (e Therandës) u ndërtua në vend të Urës së Arastës, pas djegies së saj më 1913. Në prapavijë të Urës së Re gjendet Kompleksi i Nënkalasë dhe Kalaja e Prizrenit, ndër peisazhet më të bukura të qytetit. Sot, Nënkalaja bashkë me Kalanë janë në pritje të intervenimeve të nevojshme për kthimin e pamjes së vjetër.

**Bridge of Theranda (Arasta)**

The New Bridge (of Theranda) was built to replace the Bridge of Arasta, after it got burned in 1913. In the rearward of the New Bridge, the Complex of Nënkalaja and Prizren Castle, form one of the most beautiful city landscapes. Today, both Nënkalaja and the Castle are expecting the necessary interventions to bring back the old view.

33

1930
/2009

Për EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua ne Mars të vitit 2006, nga një grup të rinjsh, kryesisht prizrenas, me përvojë në sektorin jo-qeveritar. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse, ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore, avancimi i pozitës së rinisë në proceset vendim-marrëse, promovimi i drejtësisë sociale dhe kontribuimi në proceset e integritit të Kosovës në strukturat evropiane nëpërmjet vlerave kulturore, shoqërore, qytetare dhe politike të vendit tonë. OJQ EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Europës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage. Gjithashtu, është themeluese dhe udhëheqëse e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit dhe në të njëjtën kohë edhe pjesëmarrëse e rregullt e Forumit për Trashëgimi Kulturore të Kosovës, udhëhequr nga Ministria e Kulturës.

Projektet kryesore: Forcimi i veprimtari qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 and 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Kulturizmi në Prizren (2008), Prizreni në Retrovizore (foto katalog krahasues i fotografive të Prizrenit) (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009)

About EC Ma Ndryshe

Non-Governmental organization “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” was established by a group of young people, mainly from Prizren, from different profiles with experience in the civil society sector. The main goals of organization are: promotion of active and participatory citizenship, promotion and increase awarenesses on conservation and cultivation of cultural heritage, advance youth position in decision making processes, protect and promote the human rights, promote social justice and contribute in the process of Kosovo’s integration into European structures through cultural, social, civic and political values of our country. EC Ma Ndryshe is a full and one of the founding members of South East European Network, Southeast Europe Heritage, which is a network of individuals and non-governmental working in cultural heritage field. At the same time, it is the founder and facilitator of Cultural Heritage Forum of Prizren, as well as a regular participant of the Cultural Heritage Forum of Kosovo, led by the Ministry of Culture.

Main projects: Strengthening citizens’ action in promoting and protecting cultural heritage (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Restoration Camps (2007, 2008 & 2009), Open Citizens’ Forums (2007), European Heritage Days in Kosovo (2006, 2007 and 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publications: Strategic Document: Organizing European Heritage Days in Kosovo (2008), Cultural Heritage and Cultourism in Prizren (2008), Prizren thorough the Retro-visor (comparative photo catalogue of Prizren), Volunteerism and Cultural Heritage (2009), Low cost internention (2009)

Falënderimet

Realizimi i këtij katalogu ka zgjatur afërsisht një vit, ndërsa shumë njerëz janë angazhuar që të arrihet deri tek rezultati final. Jemi të lumtur që kemi arritur ta realizojmë një nga ëndrrat tona brenda EC Ma Ndryshe, ndërsa u jemi mirënjohës shumë miqve që nuk e kursyen ndihmën e tyre. Në veçanti i falënderohemi Sokol Cenës, Edon Mullafetahut, Samir Karahodës, Arben Shalës dhe Salajdin Krasniqit. Shpresojmë se ky publikim do të arrijë sado pak të nxisë veprimin qytetar të Prizrenit dhe të shërbejë si shembull për veprime edhe më të rëndësishme dhe efektive në të ardhmen.

Financuar nga:
Financed by:



Acknowledgment

Realization of this catalogue has lasted almost a year, while many people have been actively involved to achieve the final result. We are happy to be able to fulfill one of our dreams in EC Ma Ndryshe, while we express our gratitude to many friends which contributed a great deal of work. In particular we would like to thank Sokol Cena, Edon Mullafetahu, Samir Karahoda, Arben Shala and Salajdin Krasniqi. We hope that this publication will stimulate some citizen action in Prizren and serve as an example for further and more important and effective actions in the future.



© Të gjitha të drejtat e rezervuara / All rights reserved



28 Nentori 1/10, 10000, Prishtinë, Kosovë

+381 38 522 199

info@ecmandryshe.org

www.ecmandryshe.org